



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT**

SHPLLJE PËR EKSPERT/KËSHILLTAR

Në mbështetje të Ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ishSigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (i ndryshuar), Neni 36, pika 6 “Autoriteti për realizimin e veprimtarisë sipas këtij ligji, ka të drejtë të përzgjedhë dhe të kontraktojë ekspertë të jashtëm”, të Vendimit të Autoritetit për Informim me nr. 424 datë 27/09/2022, me objekt “Për procedurën që do të ndiqet për kontraktimin e ekspertëve/këshilltarëve vendas apo ndërkombëtarë në bazë të ligjit 45/2015, i ndryshuar”, si dhe VKM nr. 187, datë 8.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, shpall Procedurat për kontraktimin e një:

Ekspert/këshilltar për fillimin e procedurës së verifikimit administrativ për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave për rastes e miratuara me vendimet përkatëse nga Autoriteti, në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore të Ligjit 45/2015, me ligjin Nr. 72, datë 20.10.2022, përditësimin dhe finalizimin e akteveve themelore të punës së Autoritetit, si edhe mbështetjen ligjore të grupit të punës së ngritur sipas urdhrit nr 34 datë 20.02.2023 për identifikimin e nevojave për përmirësime në legjislacionin dhe plotësimin e bazës ligjore për rehabilitimin dhe dëmshpërblimin e të miturve të cilët kanë vuajtur bashkë me familjet e tyre në kampet e punës, dhe detyra të tjera.

- **Kategoria e pagës III-a.**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

29.6.2023

1- Detyrat dhe përgjegjësitë:

I mbështetur nga ekipi i AIDSSH, eksperti këshillues:

- Do të përgatisë dokumentin e zgjeruar që do të paraqitet në kuadër të nismave inovative të vendeve/ organizatave të ndryshme të cilat kanë sjellë impaktin e tyre në forcimin e paqes sociale dhe sistemit demokratik qëllimin e tryezës së diskutimeve, temat kryesore dhe produktet e saj.
- Të hartojë dokumentet/Aktet me hapat konkretë për fillimin dhe kryerjen e procesit të verifikimit administrativ për çështjet e miratuara nga Autoriteti.
- Të hartojë dokumentet, ku identifikohen dispozitat dhe pikat kryesore të cilat pritet të plotësojnë bazën ligjore për rehabilitimin dhe dëmshpërblimin e të miturve të cilët kanë vuajtur bashkë me familjet e tyre në kampet e punës
- Finalizimi i akteve nënligjorë të funksionimit të Autoritetit për Informim, të bazuar në ligjet në fuqi dhe vecanërisht në Ligjin 45/2015, të ndryshuar.
- Të kryejë detyra të tjera të kërkuara nga Kryetari/ja e Autoritetit.
- Të japë mendimin ligjor për çdo çështje nëse do të kërkohet sipas nevojave të Kryetares, Anëtarëve, Drejtorive të Autoritetit.

2- Rezultatet e pritshme:

- Draftim i akteve të kërkuara në kuadër të ndryshimeve ligjore të ligjit funksional të Autoritetit me nr. 45/2015, i ndryshuar;
- Një raport përfundimtar ku përshkruhet puna e ekspertit, produktet, përfshirë rekomandimet të shoqëruara me draft aktet përkatëse, si dhe:
 - Raporti të jetë jo më pak se 10 faqe;
 - Shkrimi në llojin “Times New Roman” nr. 12.

3- Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit “Master” në fushën e jurisprudencës, të drejtës ndërkombëtare, komunikimit dhe shkencave humane (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi, si dhe e preferueshme është të ketë titull shkencor*);
- Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune;

- Të ketë eksperiencë pune konkrete në fushën e kërkimit, të drejtave të njeriut, përpunimit të strategjive, hartimit të materialeve udhëzuese, komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun;
- Të zotërojë gjuhën angleze, të folur e të shkruar dhe të prezantimit në shqip dhe anglisht. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së;
- Të plotësojë kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 12 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”; i ndryshuar;
- Të ketë eksperiencë të mëparshme të ngjashme;
- Të ketë aftësi të pëlqyeshme komunikuese;
- Të ketë aftësi për të krijuar një mjedis bashkëpunimi dhe bashkëveprimi.

4- Dokumentacioni që kërkohet, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur;
- Jetëshkrim i plotësuar;
- Fotokopje të diplomave bachelor dhe master;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, në Zyrën e Arkiv-Protokollit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit me adresë: Njësia Administrative nr. 4, Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Tiranë brenda datës **29.6.2023**

5- Njohuritë mbi legjislacionin që duhet të kenë kandidatët:

a) Njohuri mbi Ligjin Nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-

Sigurimit të Shtetit të RPSSH”;

- b) Njohuri mbi Ligjin Nr. 119/2014, “*Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare*”, i ndryshuar;
- c) Njohuri Mbi Ligjin Nr. 9887, “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar;
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, “*Për rregullat e etikës në administratën publike*”;
- f) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”;
- g) Njohuritë mbi Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- h) Njohuri mbi Ligjin Nr. 10/2023 “*Për informacionin e klasifikuar*”

6- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

7- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ishSigurimit të Shtetit do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Autoritetit, <http://autoritetidosjeve.gov.al/>. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.